

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatori Ekonomik: MALSIJA COMPANY SH.P.K. me adresë në Istog Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	22.03.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **21.03.2022**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **MALSIJA COMPANY SH.P.K.** me adresë në **Istog**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE**, me Numër të prokurimit: **623-22-1304-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-001-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e jashtë afatshme Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **MALSIJA COMPANY SH.P.K.** me adresë në **Istog**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE**, me Numër të prokurimit: **623-22-1304-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-001-5-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, pasi që e njëjta është parashtruar në kundërshtim me **Paragrafin 1 të nenit 5** dhe **Nenit 108/A** të LPP-së, si dhe **Nenin 4 pika (a)** të Rregullat për paraqitjen të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE**, me Numër të prokurimit: **623-22-1304-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-001-5-2-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik ankues: **MALSIJA COMPANY SH.P.K.** me adresë në **Istog**, si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, me datë: **21.03.2022** në Ora: **15:02 h**

Shih tabelën nëpërmjet sistemit te e-prokurimit:

1. Kërkesat për rishqyrtim					
Data e dërgimit	Ofertuesi	Përshkrimi	Statusi i pyetjeve	Shkarko pyetjen	Shkarko përgjigjen
21.03.2022 15:02	MALSIJAJ COMPANY SH.P.K.	Kërkesë për Ri-Shqyrtim	Paraqitur	Shkarko 	
Vazhdo 					

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Operatori Ekonomik ankues: **MALSIJA COMPANY SH.P.K.** me adresë në **Istog**, ka bërë kërkesë për rishqyrtim përmes e-prokurimit me datë: **21.03.2022** në Ora: **15:02 h**.

Pra nga sqarimet e dhëna si me lart mund të konkludojm se OE ankues, Kërkesën për Rishqyrtim e ka paraqitur ne kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 5 të LPP-së në të cilën thuhet: ***Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit***, andaj i njëjti ka ushtruar mjetin juridik ne AK jashtë afatit ligjore të paraparë me Ligjin e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës dhe akteve nen ligjore për prokurim publik.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si me lart AK Komuna e Rahovecit, konstaton se ankesa e OE-së: **MALSIJA COMPANY SH.P.K.** me adresë në **Istog**, e parashtruar me datën: **21.03.2022** në Ora: **15:02 h**, është e jashtë afatshme për faktin se nuk ka vepruar konform nenit 4 të rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrimin të ankesave pran OSHP-së dhe vlera e tarifave të ankesave, konkretisht nuk është respektuar “Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesë për rishqyrtim pran Autoritetit Kontraktues”, ku në nenin 4.1 pika a. thuhet: Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme: ***Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.***

Gjithashtu ka edhe interpretim nga OSHP lidhur me rast te ngjashëm për refuzim te një kërkesë te tille si ne vijim, i cili mund te merret parasysh:

<file:///C:/Users/ASTRIT~1/MUL/AppData/Local/Temp/752-21%20vendim-1.pdf>

<file:///C:/Users/ASTRIT~1/MUL/AppData/Local/Temp/705-21vend.pdf>

<file:///C:/Users/ASTRIT~1/MUL/AppData/Local/Temp/691-21%20vendim.pdf>

Prandaj Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit vjen në përfundim se Operatori Ekonomik ankues: **MALSIJA COMPANY SH.P.K.** me adresë në **Istog**, e ka lëshuar afatin ligjore për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit